



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 30

Prishtinë, më 18.02.2016 në orën: 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

Procesverbal

i mbledhjes së komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Xhevahire Izmaqi, Alma Lama, Jelena Bontić.

Munguan: Shqipe Pantina, Pal Lekaj, Zafir Berisha dhe Kujtim Paçaku.

Në mbledhje morën pjesë: kryetari i Bordit të RTK-së, drejtori i menaxhmentit dhe zyrtari i zyrës ligjore, përfaqësuesit e OSBE, KDI, BIRN, ZPRK, Radio- Kosova dhe RTV 21.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Për këtë mbledhje është propozuar ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Plotësim – ndryshimi i Ligjit për RTK- në, nr. 04/L-046;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Plotësim – ndryshimi i Ligjit për RTK- në, nr. 04/L-046

Zenun Pajaziti – I njoftoi anëtarët e komisionit dhe përfaqësuesit e RTK-së, se në plotësim - ndryshimin e Ligjit për RTK-në, Komisioni do të fokusohet vetëm në çështjen e financimit të qëndrueshëm të RTK-së. Ai kërkoi nga përfaqësuesit e RTK-së që të prezantojnë propozimet e tyre për plotësim ndryshimin e Ligjit duke mos përjashtuar propozime të tjera, por të arsyeshme.

Alma Lama – Tha se komisioni është i njoftuar me propozimet e RTK-së që nga viti i kaluar dhe tani kemi të njëjtin qëndrim rreth propozimeve të RTK-së. Ajo propozoi se ligji nuk ka nevojë të amendamentohet, por komisioni duhet të gjejë një zgjidhje për financimin e RTK-së dhe çdo propozim tjetër është i panevojshëm, dhe ky është mesazh që RTK-ja e ka marrë edhe nga Komisioni Evropian. Prandaj mbi këtë bazë është e domosdoshme që RTK-ja duhet të sjellë propozime për rritjen e llogaridhënies së vet RTK-së.

Sadri Ferati - Propozoi që përfaqësuesit e RTK-së të prezantojnë propozimet e tyre lidhur me plotësim ndryshimin e ligjit, apo edhe ndonjë ide tjetër lidhur me financimin e RTK-së.

Xhevahire Izmaku – Propozoi që të dëgjohen propozimet e përfaqësuesve të RTK-së në mënyrë që në mbledhjen e radhës edhe anëtarët e komisionit t'i shqyrtojnë, plotësojnë apo edhe t'i kundërshtojnë si p.sh. është çështja e kanaleve të reja televizive, nuk mund të anashkalojmë faktin që të shqyrtojmë edhe çështjen e kanaleve televizive.

Ismet Bexheti – Tha se është e nevojshme ndryshimi i ligjit sepse në vitet e fundit në RTK ka pasur zhvillime dhe ndryshime, të cilat kanë reflektuar në aspektin financiar të RTK-së.

Mentor Shala – Gjithashtu tha se ligji duhet të ndryshohet për arsye se RTK-ja ka pësuar ndryshime sipas obligimeve që dalin nga kushtetuta dhe zbatimi i dispozitave ligjore të ligjit në fuqi, siç janë hapja e kanaleve televizive etj., nga domosdoshmëria e digjitalizimit të arkivave të vjetra dhe produksionit të ish RTP-së.

Si çështje me rëndësi për ndryshimin e ligjit janë çështja e financimit, çështja e pronës dhe çështja e platformës. RTK-ja tani ka të garantuar një multiplex d.m.th. një frekuencë për të cilën kemi draft- projektet e gatshme, në bazë të këtyre fakteve RTK-ja ka modifikuar propozimet lidhur me amendamentimin e Ligjit për RTK- si vijon:

Neni 6 - Prona e Radio- Televizionit të Kosovës:

“Kuvendi i Kosovës me vendim të veçantë do t'i caktojë RTK-së pronën me lokacion të ri në ish-ndërtesën e Radio Kosovës”.

Neni 8, paragrafi 2 përbërja, skemat e RTK-së:

2. RTK përfshinë:

2.1. 5 (pesë) kanale televizive:

2.1.1. RTK TV 1, RTK TV 2, RTK TV 3, RTK TV 4, RTK TV 5,

2.1.2. RTK TV 2 është kanali televiziv në gjuhën serbe,

2.2. 2 (dy) kanale të radios të Kosovës,

2.2.1. Radio -Kosova 1 dhe Radio- Kosova 2,

3. RTK TV 1 dhe RTK TV 2 janë, të detyruara të ndajnë pesëmbëdhjetë për qind (15%) të skemës së tyre programore për gjuhët e komuniteteve të tjera të Kosovës.

Paragrafi 7 i Nenit 8 të fshihet në tërësi me arsyetim se kanali televiziv RTK TV 2 funksionon që nga 4 qershori 2013.

Neni 21, paragrafi 4

Propozojmë që paragrafi 4 i nenit 21 të riformulohet sikurse vijon:

RTK-së çdo vit i ndahet 1.5% e Buxhetit të përgjithshëm të Kosovës.

Ndërsa **Paragrafët 3 dhe 5 të nenit 21** të fshihen në tërësi.

Neni 23, paragrafi 2 - Financimi nga Themeluesi

Menaxhmenti i RTK-së për projekte zhvillimore mund të bëjë marrëveshje në të cilën përfshihet huazimi i parave, zgjatja e një huadhënie ose vendosja e një kredie, me miratim paraprak nga Bordi i RTK-së.

Neni 26, paragrafi 3

Mandati i anëtarëve të Bordit të RTK-së është 5 (pesë) vjeçar.

Paragrafi 4

Mandati i kryetarit dhe nënkryetarit të Bordit të RTK-së është 4 (katër) vjet, me mundësi të rizgjedhjes vetëm edhe për një mandat.

Neni 32 paragrafi 2

Drejtori i përgjithshëm i RTK-së emërohet me shumicën e thjeshtë dhe shkarkohet me 2/3 e votave të anëtarëve të Bordit. Mandati i Drejtorit të Përgjithshëm do të jetë 5 (pesë) vjet me mundësi rizgjedhje.

Neni 35 paragrafi 1

Bordi i RTK-së sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm, emëron zëvendës drejtorët e përgjithshëm, drejtorët e të gjitha kanaleve të radios dhe televizionit dhe udhëheqësin e shërbimeve të përbashkëta, në bazë të kualifikimeve profesionale pas procesit të hapur dhe transparent.

Propozohet që paragrafët 1.1., 1.2., 1.2.1., 1.2.2., 1.2.3., 1.2.4., 1.3, dhe 1.3.1. të nenit 35 të fshihen në tërësi me arsyetimin se RTK TV 2 tashmë është kanal i konsoliduar dhe rrjedhimisht janë të tejkaluar.

Neni 35 paragrafi 9

Drejtorët e të gjitha kanaleve të radios dhe televizionit si dhe udhëheqësi i shërbimeve të përbashkëta, zgjedhën për 5 (pesë) vjet me mundësi të rizgjedhjes.

Neni 36

Ombudspersoni i RTK-së

1. Bordi i RTK-së e emëron Ombudspersonin e RTK-së.

2. Ombudspersoni shqyrton:

2.1. Vërejtjet dhe sugjerimet e shikuesve dhe dëgjuesve;

2.2. I raporton Bordit të RTK-së për çështjet e caktuara lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e publikut;

2.3. Kryen punë të tjera të caktuara me Statut.

2.4 Ombudspersonit emërohet me mandate 5 (pesë) vjeçar me mundësi të rizgjedhjes.

4. Procedurat e emërimit të Ombudspersonit të RTK-së do të rregullohen me Statut të RTK-së.

Neni 40 paragrafi 2

Me miratimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të këtij Ligji, bordi aktual dhe menaxhmenti aktual i RTK-së do të vazhdojnë t'i kryejnë detyrat e përcaktuara dhe të përmbushin mandatet e tyre sipas këtij Ligji.

Konstatim: Komisioni ka vendosur unanimisht që propozuesit e këtyre propozim - amendamenteve t'i sjellin arsyetimet për secilin ndryshim të sipërsënuar.

Mbledhja përfundoi në orën: 12:15.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Zenun Pajaziti